



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL  
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 02.04.2019

## **NJOFTIM PUNËSIMI**

Në zbatim të Urdhërit nr. 20 datë 19.01.2018, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për krijimin e sporteleve unike të shërbimeve për fermerët – “Agropika”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për:

### **SPECIALIST INFO-APLIKIM**

#### **PËR AGROPIKAT:**

**LEZHË – SARANDË – ELBASAN – LIBRAZHD - PUKË**

#### **Detyrat kryesore të Specialistit Info-Aplikim janë:**

- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural të financuar nga Bashkimi Evropian (IPARD II), si dhe donatorë të tjerë.
- Të japë informacion mbi Fondet e Garancisë dhe lehtësirat financiare që ofrojnë tregjet bankare dhe financiare për fermerët.
- Të japë informacion mbi politikat e zhvillimit të sektorit bujqësor dhe blegtoral.
- Të japë informacion mbi tregjet bujqësore dhe blegtorale.
- Të kryejë regjistrimin e të dhënave të fermës bujqësore dhe blegtorale sipas sistemeve të vëna në funksion.
- Të bëjë pranimin e aplikimeve për mbështetjen financiare nga fondet e skemave kombëtare.
- Të bashkëpunojë me zyrat shtetërore, bashkitë, bankat, donatorët apo grupet e fermerëve/shoqatave për ofrimin e shërbimeve.
- Të raportojë pranë AZHBR qendër në mënyrë periodike.
- Të raportojë problematikat apo idetë dhe kërkesat e fermerëve.

## **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

## **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë universitar, niveli Bachelor,  
*(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë përvojë pune ose internshipi.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 12.04.2019, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjolleasha”, Nr. 56, Tiranë), kërkesën për punësim, një kopje të CV të përditësuar, diploma e noterizuar, certifikata të kualifikime të ndryshme, një fotokopje e librezës së punës, një kopje të ID-së.**

**Të gjithë kandidatët që aplikojnë, do të marrin informacion vetëm në faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:**

- për rezultateve të verifikimit paraprak/përfundimtar
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**